



## Raport i vlerësimit të trajnimit “Mjetet dixhitale dhe mësimdhënia online”

Prishtinë, Qershor 2020

## Tabela e përmbajtjes

<b>LISTA E FIGURAVE .....</b>	<b>3</b>
<b>LISTA E TABELAVE .....</b>	<b>3</b>
<b>1. GJENDJA E ARSIMIT TË MESËM DHE TË ULËT SI REZULTAT I PANDEMISË COVID19 .....</b>	<b>4</b>
<b>2. TRAJNIMI “MJETET DIXHITALE DHE MËSIMDHËNIA ONLINE” .....</b>	<b>5</b>
1.1. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT .....	5
1.2. METODOLOGJI PEDAGOGJIKE ONLINE .....	6
1.3. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT ONLINE .....	8
<b>2. ORGANIZIMI I TRAJNIMIT .....</b>	<b>8</b>
2.1. Pjesëmarrësit e trajnimit .....	8
<b>3. KRAHASIMI I SITUATËS ME MËSIMIN ONLINE PARA DHE PAS MBAJTJES SË TRAJNIMIT .....</b>	<b>10</b>
3.1. NDIKIMI I TRAJNIMIT NË ZHVILLIMIN E NJOHURIVE PËR ORGANIZMIN E MËSIMIT ONLINE TE MËSIMDHËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME .....	14
3.2. NDIKIMI I TRAJNIMIT NË ZHVILLIMIN E NJOHURIVE PËR ORGANIZMIN E MËSIMIT ONLINE TE MËSIMDHËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA .....	21
<b>4. DISKUTIM I REZULTATEVE DHE PËRFUNDIME .....</b>	<b>26</b>
<b>ANEKSET .....</b>	<b>28</b>

## Lista e figurave

Figura 1. Komunitat nga vijën pjesëmarrësit e trajnimit .....	9
Figura 2. Klasët në të cilat pjesëmarrësit mbajnë mësim .....	10
Figura 3. Njohuritë teknologjike të mësimitdhënësve .....	11
Figura 4. Mjetet teknologjike më të përdorura nga mësimitdhënësit .....	12
Figura 5. Nevojat e mësimitdhënësve për trajnim .....	13
Figura 6. Mënyra e komunikimit me nxënësit .....	14
Figura 7. Vazhdimi i aplikimit të elementeve të mësimit online .....	15
Figura 8. Opinione të mësimitdhënësve për mësimitdhënien online në të ardhmen .....	16
Figura 9. Nidhma e pranuar për zhvillimin e mësimit online .....	16
Figura 10. Interesimi i nxënësve të shkollave të mesme për mësimit online .....	18
Figura 11. Ndryshimi në interesin e nxënësve të shkollave të mesme për mësimit online .....	19
Figura 12. Përfitimet e mësimitdhënësve nga trajnimi .....	19
Figura 13. Vlerësimi i mësimitdhënësve për trajnimin "Mjetet dixhitale dhe mësimitdhënien online" .....	20
Figura 14. Vazhdimi i përdorimit të elementeve të mësimit online në të ardhmen .....	21
Figura 15. Përfshirja e mësimit online në planin programatik të ardhshëm .....	22
Figura 16. Nidhma e pranuar në krijimin e klasëve online gjatë pandemisë Covid19 .....	23
Figura 17. Interesimi i nxënësve të shkollave fillore për mësimit online .....	24
Figura 18. Ndryshimi i nxënësve të shkollave fillore për mësimit online .....	25

## Lista e tabelave

Tabela 1. Niveli i njohurive teknologjike të mësimitdhënësve .....	12
Tabela 2. Mbështetësit më të mëdhenjë të mësimitdhënësve gjatë mësimit online .....	17
Tabela 3. Nidhma e ofruar për mësimitdhënësit gjatë kohës së pandemisë .....	23
Tabela 4. Ndikimi i trajnimit në zhvillimin e njohurive teknologjike të mësimitdhënësit .....	26

## 1. Gjendja e arsimit të mesëm dhe të ulët si rezultat i pandemisë COVID19

Për shkak të pandemisë Covid19 mësimi i rregullt për të gjitha nivelet arsimore në Republikën e Kosovës është ndërprerë më datën 12 mars 2020 me rekomandim të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës. Si rrjedhojë, nga ndërpreja e procesit mësimor u ndikuan rreth 360,000 nxënës nga 1,116 shkolla në të gjithë territorin e Kosovës, nga të cilat 43 çerdhe, 948 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 125 shkolla të mesme si dhe 104,606 studentë nga institucionet private e publike të arsimit të lartë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>).

Si përgjigje ndaj situatës, Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), filloi transmetimin televiziv të mësimave për disa lëndë shkollore përmes Radio Televizionit të Kosovës. Transmetimi i mësimit online filloi më 23 mars 2020 dhe në të u përfshinë vetëm arsimit fillor dhe i mesëm i ulët, do të thotë klasët nga 1 deri në 9, duke u lënë jashtë shkollat e mesme të larta.

Ndonëse transmetimi i mësimave përmes televizionit ishte hap i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor në kushte të distancimit social dhe kufizimit të lëvizjes, procesi është shoqëruar me mangësi dhe kritika të shumta. Ndër mangësitë kryesore të kësaj forme të mësimit paraqet uniformiteti i njësive mësimore për të gjithë nxënësit pavarësisht progresit të tyre, pamundësia e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve, dhe pamundësia e përcjelljes dhe vlerësimit të angazhimit të nxënësve, duke mos lënë anash edhe problemet e shumta teknike në rrjedhën e informacionit në mes të nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve.

Në kushte të tilla të distancimit fizik, mjetet digjitale ofrojnë një mundësi të mirë për sigurimin e vazhdimet të proceseve mësimore normalisht. Ndonëse disa institucione arsimore ose mësimdhënës të caktuar menjëherë kanë filluar me përdorimin e mjeteve digjitale dhe platformave online për zhvillimin e mësimit, kjo nuk ishte një praktikë e përgjithshme dhe shume prej institucioneve janë mbështetur vetëm në sesionet mësimore online të ofruara nga MASHTI përmes transmetuesit publik. Kjo mund të ketë qenë për shumë arsye, por ndër kryesoret del të jetë niveli i ulët i njohurive për përdorimin e mjeteve digjitale nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.

Një studim tregon se vetëm 57% e mësimitdhënësve kanë ndjekur më herët trajnime për përdorimin e mjeteve digjitale në mësim. (Duraku & Hoxha, 2020)

Kosova është e njohur për nivelin e lartë të përdorimit të internetit, ku sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deri në vitin 2019 93.2% e amvisërive kanë deklaruar se kanë qasje në internet nga çfarëdo pajisje (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019). Ky nivel i lartë i shtrirjes së internetit në Kosovë duhet të përdoret në shërbim ofrimit të arsimit cilësor për të gjithë nxënësit pa dallim. Për këtë arsye, ISEPS në bashkëpunim me Kolegjin Universum kanë organizuar trajnimin “Mjetet dixhitale dhe mësimitdhënia online” për mësimitdhënësit e shkollave të mesme dhe fillore, me qëllim të ngritjes së kapaciteve të tyre për organizimin e klasëve dhe mbajtjen e mësimit online.

## 2. Trajnimi “Mjetet dixhitale dhe mësimitdhënia online”

Instituti për Studime Ekonomike, Politike dhe Sociale (ISEPS) në bashkëpunim me Kolegjin Universum gjatë muajit Prill 2020 ka organizuar trajnimin online “Mjetet dixhitale dhe mësimitdhënia online” për mësimitdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës.

ISEPS është çertifikuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës për ofrimin e këtyre trajnimeve dhe ato janë ofruar falas për të gjithë pjesëmarrësit.

### 1.1. Qëllimi dhe përmbajtja e trajnimit

Ky trajnim është krijuar më qëllim që t’i aftësojë mësimitdhënësit në dizajnimin e lëndëve mesimore online dhe në përdorimin e mjeteve teknologjike të cilat e mundësojnë organizimin e ligjeratave të efektshme dhe përmirësojnë përvojën e të mësuarit tek studentët. Duke u nisur nga fakti që mësimitdhënia online është metodë relativisht e re, trajnimi është fokusuar në pjesët bazike të dizajnit të lëndëve online. Vetë trajnimi është zhvilluar krejtësisht online dhe përveç mjeteve dhe platformave dixhitale për mbajtjen e mësimit online, ai ka mbuluar edhe metodologjitë pedagogjike dhe metodologjitë e vlerësimit të cilat janë më të përtatshme për mësimitdhënie online dhe menaxhimin të kohës gjatë mësimit të rregullt.

Synim i trajnimit ka qenë që mësimitdhënësve t’ua zhvillojë:

- Të kuptuarit e trendeve globale të arsimit dhe rëndësisë së mësimdhënies online;
- Aftësitë e krijimit të lëndëve online përmes përdorimit të Google Classroom;
- Aftësitë e krahasimit në mes të metodologjive pedagogjike më të përshtatshme për mësimdhënien online;
- Aftësitë e organizimit të sesioneve të ligjeratave online përmes platformës Zoom ose Google Hangout;
- Aftësitë e krahasimit në mes të mësimdhënies konvencionale (face-to-face) dhe mësimdhënies online;
- Aftësitë e krahasimit në mes të vlerësimit auditues dhe vlerësimit edukues në kushte të mësimin online ku vlerësimi bëhet me ‘libra të hapur’ (open book).

Trajnimi është ofruar 100% online, ka zgjatur tetë orë mësimore dhe është ndarë në katër sesione të cilat përfshijnë:

- Njoftimi me ligjëruesit dhe prezantimi i planprogramit
- Rëndësia e mësimdhënies online
- Platformat e ndryshme dixhitale të cilat mundësojnë mësimdhënien online
- Krijimi i lëndës në Google Classroom
- Organizimi i mësimin OFFLINE dhe inçizimi i sesioneve
- Planifikimi i mësimin online
- Vlerësimi i studentëve online
- Krijimi i ligjeratës në Zoom ose Google Hangout
- Krijimi i testeve online përmes Google Forms

Siç mund të shihet, theks i veçantë gjatë trajnimit i është kushtuar edhe metodologjisë pedagogjike dhe vlerësimit online të studentëve.

## 1.2. Metodologji Pedagogjike online

Në kuadër të metodologjisë pedagogjike është diskutuar për rëndësinë e përshtatjes së lëndës për mësimin online dhe dizajnimin e zhvillimin e planit mësimor.

Metodologjia e sugjeruar përfshin dizajnimin e rezultateve të pritura, aktiviteteve dhe mënyrës së vlerësimit duke duke u bazuar në faktorët e situatës si numri i nxënësve dhe profili i tyre, pesha e lëndës në kuadër të planprogramit, raporti i pjesës teorike dhe praktike në kuadër të lëndës, platforma online që është duke u përdorur si dhe profili i mësimdhënësës/it.

Këtu janë trajtuar Taksonomia e Bloom-it dhe Taksonomia e Dee Fink-ut, me fokus më të madh në këtë të fundit. Kjo për shkak se si taksonomi ajo përfshin të gjitha aspektet e lëndës, dizajnimin dhe implementimit të saj. Ajo orienton dizajnimin e lëndës duke u bazuar në njohuritë bazike, aplikimin e njohurive dhe shkathtësitë e nxënësve, integrimin dhe ndërlidhjen e tyre me fusha të ndryshme jetësore, dimensionin human të të kuptuarit të vetës dhe të tjerëve, kujdesin dhe zhvillimin e interesave dhe vlerave të reja, si dhe të mësuarit se si të mësohet/studiohet.

Pjesëmarrësve u janë prezantuar tri parime kryesore të të mësuarit online, të cilat përfshijnë:

1. **Lejo nxënësit të kryejnë shumicën e punës** – i cili kërkon që i gjithë procesi të fokusohet rreth nxënësit, t'i mbajë nxënësit aktivë dhe ta nxisë bashkëpunimit mes tyre nepërmjet pyetjeve të hapura, rasteve studimore, problemeve për t'u zgjidhur, pikëpamjeve të ndryshme për një problem, si dhe strategjisë Jigsaw. Kjo bëhet me qëllim që të maksimizojë mësimnxënien përmes problemeve intriguese për nxënësit dhe të promovojë mendimin kritik, aftësitë për të zgjidhur problemet, komunikimin etj.
2. **Mbështetu në platformat për menaxhimin e procesit mësimor (LMS)** – që kërkon që të zgjedhet një platformë përmes së cilës do të mbahet mësimi online dhe t'u komunikohen qartë nxënësve karakteristikat e përdorimit të saj. Ky parim gjithashtu thekson rëndësinë e prezencës së shtuar online të mësimdhënësve me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të lëndës dhe krijimit të një modeli të aktivitetve dhe ligjëratave që do të përcillet gjatë gjithë semestrit, si dhe rritjes së pjesëmarrjes në klasë.
3. **Përgatit, Përgatitu, Përgatitu!** – i cili kërkon që mësimdhënësi ta planifikojë mirë orën mësimore paraprakisht, t'i ftojë të gjithë nxënësit në sesionin mësimor online, të sigurohet që është duke funksionuar mirë platforma digjitale që do ta përdorë, të sigurohet që të gjitha linqet që do të përdoren të jenë funksionale, që të gjitha materialet që do të përdoren janë gati, si dhe të sigurohet që janë caktuar paraprakisht të gjitha detyrat që do t'u jepen nxënësve.

### 1.3. Metodologjia e vlerësimit online

Trajnimi ka inkurajuar aplikimin e vlerësimit edukues gjatë mësimit online në vend të vlerësimit tradicional auditues.

Vlerësimi edukues fokusohet në vlerësimin e të kuptuarit të nxënësve se si lidhet moduli/lënda me jetën e përditshme. Ai është më modern, përfshin feedback-n FIDELITY dhe vetëvlerësimin e nxënësve, për dallim nga vlerësimi auditues që fokusohet vetëm në atë se a di nxënësi/ja materialin e mbuluar gjatë lëndës.

Feedback-u FIDELITY kërkon që nxënësve t'u jepet vlerësim sa më i shpeshtë, i menjëhershëm në mënyrë që të jetë i freskët dhe nxënësit të kenë mundësinë të mësojnë nga ai, diskriminues në mënyrë që nxënësit të mund t'a bëjnë dallimin në mes të punës së mjaftueshme dhe të mirë apo shumë të mirë, dhe së fundi i përzemërt në mënyrë që nxënësit të mund ta pranojnë lehtë dhe të mësojnë nga një feedback empatik.

Trajnimi ka inkurajuar forma të vlerësimit online në të cilat minimizohet nevoja e nxënësve për të konsultuar materialet gjatë testimit. Që të arrihet kjo sugjerohet të minimizohen pyetjet e mbyllura, të krijohet një listë e gjerë me pyetje dhe të shpërndahet nëpër grupe, të randomizohen pyetjet, pyetjet të fokusohen në zgjidhjen e problemeve dhe në raste studimore, dhe t'u jepen nxënësve më shumë detyra dhe prezantime grupore.

Për qëllim të përmirësimit të procesit të vlerësimit online, pjesëmarrësve të trajnimit u janë prezantuar një numër platformash digjitale të cilat mundësojnë vlerësimin diagnostikues, formative dhe përmbledhës.

## 2. Organizimi i trajnimit

### 2.1. Pjesëmarrësit e trajnimit


Trajnimi “Mjetet dixhitale dhe mësimdhënia online” është ofruar për 1430 msimdhënës të 85 shkollave të mesme dhe 128 shkollave fillore dhe të mesme të ulëta nga i gjithë territori i Kosovës. Listat e shkollave mësimdhënësit e të cilave kanë marrë pjesë në trajnim janë paraqitur në aneks. Nga ta, përqindja më e madhe e pjesëmarrësve në trajnimin e mbajtur është nga Komuna e

Prishtinës, të cilët përbëjnë 25% të të gjithë të trajnuarve, pasuar nga Komuna e Gjakovës me 13.6% të të trajnuarve dhe nga Komuna e Therandës dhe Komuna e Vushtrrisë me nga 9%. Është e rëndësishme të përmendet që në trajnim janë përfshirë edhe mësimdhënës nga komunat më të largëta/izoluara të Kosovës, si Mamusha, Juniku, Shterpca, Dragashi, Hani i Elezit, etj. Kjo tregon për mbulueshmëri të lartë dhe gjithëpërfshirje të trajnimit të mbajtur, për dallim nga iniciativat e deritanishme të fokusuara në qendrat kryesore.

Figura 1. Komunat nga vijnë pjesëmarrësit e trajnimit

Vendi

1,430 responses



Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

Trajnimi gjithashtu ka mbuluar një gamë të gjerë të lëndëve që mësimdhënësit e trajnuar i ligjerojnë, duke mos anashkalluar edhe stafin menaxhues të shkollave. Kështu, nga numri total i të trajnuarve, në mënyrë proporcionale me numrin e lëndëve të ofruara në shkollat e mesme, janë përfshirë 151 mësimdhënës të Gjuhës Shqipe, 165 të Gjuhës Angleze, 173 të Matematikës, 405 të lëndëve profesionale, 173 të pozitave menaxhuese dhe pjesa e mbetur nga lëndët e tjera të gjuhëve, arteve dhe sporteve.


Në trajnim gjithashtu janë përfaqësuar të gjitha klasët dhe nivele të ndryshme të nivelit arsimor. Shpërndarja e mësimdhënësve sipas klasëve në të cilat ata ligjerojnë është paraqitur në figurën 2. Këtu shihet se shumica e mësimdhënësve të trajnuar japin mësim në klasët e dhjeta. Megjithatë një shumicë e madhe e tyre japin mësim në më shumë se dy klasë. Një përqindje më të vogël të të

trajnuarve paraqesin mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulët (20.8%) dhe ata të shkollave fillore (16.1%).

Figura 2. Klasët në të cilat pjesëmarrësit mbajnë mësim

#### Klasët ku mbani mesim

1,430 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

### 3. Krahasimi i situatës me mësimin online para dhe pas mbajtjes së trajnimit


Për ta bërë të mundur matjen e impaktit të trajnimit në zhvillimin e aftësive të mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit, atyre u është kërkuar para fillimit të trajnimit që t'i vlerësojnë njohuritë e tyre në këtë aspekt. Shumica e mësimdhënësve, ose 54.8%, kanë deklaruar se kanë njohuri mesatare, 14.9% kanë thënë se kanë njohuri bazike, 20% kanë njohuri mbi mesatare dhe vetëm 10.3% kanë deklaruar se kanë aftësi të shkëlqyshme. Kjo nënkupton që vetëm 30.3% e mësimdhënësve kanë aftësi teknologjike mbi mesataren.

Fakti që, nën kushte kur i gjithë procesi i mësimdhënies duhet të zhvillohet në formë elektronike, vetëm një përqindje kaq e vogël e mësimdhënësve kanë njohuri teknologjike mbi mesatare dëshmon nevojën e madhe për mbajtjen e këtij trajnimi. Të dhënat e detajuara janë paraqitur në figurën 3.

Figura 3. Njohuritë teknologjike të mësimeve

Si i vlerësoni njohuritë tuaja në teknologji?

1,430 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimeve

Deri në fillimin e trajnimit, 95% e mësimeve kanë deklaruar se kanë filluar organizimin e klasëve online. Mjetet digjitale më të përdorura nga ta për mbajtjen e mësimit online janë Zoom, e zgjedhur nga 64.2% e mësimeve, pastaj Google Classroom e zgjedhur nga 53.9% e tyre, ndërsa mjetet të tjera si Google Meet, Moodle, dhe Google Hangouts janë zgjedhur nga më pak se 10% e mësimeve. Këtu është e rëndësishme të përmendet që këto mjete digjitale përdoren së bashku me mjete të tjera të komunikimit si email, Whatsapp dhe Viber, Facebook etj. Kombinimi më i shpeshtë i përdorur është ai Zoom dhe Google Classroom të cilin kanë deklaruar se e përdorin gjithsej 26.34% e mësimeve, pasuar nga kombinimi Zoom dhe Email ose Whatsapp që është përdorur nga 8.49% e tyre. Të dhënat e detajuara janë paraqitur në grafikun në vijim.



<b>Google Classroom</b>	195	13.60	330	23.10	395	27.60	173	12.10	87	6.10
<b>Moodle</b>	605	42.30	85	5.90	58	4.10	19	1.30	10	0.70
<b>Facebook for Education</b>	284	19.90	167	11.70	228	15.90	135	9.40	123	8.60
<b>WhatsApp/Viber</b>	53	3.70	107	7.50	348	24.30	262	18.30	329	23.00
<b>Email</b>	18	1.30	97	6.80	359	25.10	291	20.30	383	26.80


*Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime të mësimdhënësve*

Duke qenë se platformat Zoom dhe Classroom janë më të përdorurat nga mësime të mësimdhënësve, natyrshëm ata kanë deklaruar se më së shumti kanë nevojë për trajnime në përdorimin e këtyre të dyjave. Kështu, 37.6% e mësime të mësimdhënësve kanë pasur nevojë për trajnime shpesh në përdorimin e Google Classroom, 36.6% në përdorimin e Zoom, 9.3% në Google Meets dhe 11.5% kanë deklaruar se nuk dinë për cilën kanë nevojë më shumë për trajnim. Ndërsa për platformën Moodle, përkundrazi mungesës së madhe të njohurive, mësime të mësimdhënësve nuk kanë deklaruar se kanë nevojë për trajnim. Figura 6 më poshtë i tregon këto të dhëna.

*Figura 5. Nevojat e mësime të mësimdhënësve për trajnim*

Per cilen platforme dixhitale keni me shume nevoje per trajnim?

1,430 responses



*Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime të mësimdhënësve*

Pjesa më e madhe e mësime të mësimdhënësve, apo shprehur në përqindje 69.4%, i organizojnë orët për secilën klasë veç e veç. Ndërsa një pjesë më e vogël, 13.5%, i organizojnë ato me të gjitha klasët së bashku përnjëherë. Sa i përket numrit të orëve, 34.7% e mësime të mësimdhënësve organizojnë nga 1-5 orë mësimore në javë, 23.3% organizojnë nga 6-10 orë, 30.8% mbajnë nga 11-20 orë, 8% nuk kanë


organizuar asnjë orë mësimore online në kohën e intervistimit ndërsa 8% kanë organizuar mbi 20 orë.

Mënyra që mësime të përdorin për të vënë kontakt me nxënësit e tyre lidhur me mbajtjen e mësimit online janë kontakti përmes emailit, i aplikuar nga 57.6% e mësimeve dhe kontakti përmes telefonit, i aplikuar nga 37% e mësimeve. Vetëm një numër i vogël i mësimeve, apo 5.4%, deri në kohën e intervistimit nuk kanë vendosur kontakt me nxënësit. Kjo përqindje është e përafërt me atë të mësimeve të cilët kanë deklaruar se nuk janë duke mbajtur asnjë orë mësimi online.

Figura 6. Mënyra e komunikimit me nxënësit

Si do të vendosni kontakt me nxënësit për ligjeratat online?

1,430 responses



Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime të përdorin

### 3.1. Ndikimi i trajnimit në zhvillimin e njohurive për organizimin e mësimit online të mësimeve të shkollave të mesme


Kur janë pyetur nëse edhe pas kthimit të mësimit në klasët fizike mësime të vazhdojnë të përdorin elemente të mësimit online, 88.5% kanë deklaruar se ata do të vazhdojnë, 2.3% kanë thënë që nuk do të vazhdojnë, ndërsa pjesa tjetër apo 9.3% kanë deklaruar se nuk janë të sigurtë. Një shkallë e lartë e gatishmërisë për të vazhduar me përdorimin e elementeve të mësimit online tregon për dobishmërinë e madhe të përdorimit të mjeteve teknologjike në mësime të shohin mësimeve të përdorin.

Elementet të cilat mësime dhënësit kanë deklaruar më së shpeshti se do t'i përdorin janë vlerësimi edukues, platformat si Zoom, Google Classroom, ose LMS të tjerë, ndarja e linqeve të ndryshme me nxënësit dhe incizimi i ndonjë pjese të sesioneve mësimore.

Figura 7. Vazhdimi i aplikimit të elementeve të mësimit online

Nese mesimdhënia e drejtperdrejte (F2F) do te kthehet ne shtator, a do te vazhdoni te aplikoni aspekte te mesimdhënies online?

443 responses




Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime dhënësit

Siç shihet në grafikun 8 të paraqitur më poshtë, një masë edhe më e madhe e mësime dhënëseve, 92.1% më konkretisht, besojnë se mësimi online duhet të bëhet pjesë e planprogramit mësimor në të ardhmën. Një pjesë shumë e vogël, apo 1.8% mendojnë se ajo nuk duhet të jetë pjesë e planprogramit, ndërsa vetëm 6.1% nuk janë të sigurtë.

Figura 8. Opinonet e mësimeve për mësime online në të ardhmen

A mendoni që mësime online duhet të jete pjese e planprogramit edhe ne te ardhmen?

443 responses




Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime

Pyetësi i zhvilluar me pjesëmarrësit e trajnimit tregon se një e treta e tyre, apo 33.2%, asnjëherë më parë nuk kanë marrë ndihmë nga dikush tjetër për organizimin e mësimit online. Vetëm 18.7% kanë deklaruar se kanë marrë ndihmë nga MASHTI dhe një pjesë e madhe, 52.4%, kanë deklaruar se kanë marrë ndihmë nga kolegët e tyre.

Figura 9. Nidhma e pranuar për zhvillimin e mësimit online

A keni marre ndihme nga dikush tjetër për të krijuar kursin online?

443 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime

Njësoj duket se përgjithësisht edhe mbështetjen më të madhe gjatë pandemisë mësimit online e kanë marrë nga kolegët e tyre. Kështu, në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 5 nënkupton mbështetje të madhe dhe 1 nënkupton aspak mbështetje, ata e kanë vlerësuar mbështetjen e dhënë nga kolegët e tyre me 4.19, mbështetjen nga nxënësit me 3.97, mbështetjen nga shkolla me 3.93 dhe më pas si mbështetje më të vogël kanë deklaruar të kenë marrur nga MASHTI me 3.47, nga Komunitat dhe DKA-të me 3.20 dhe së fundi nga prindërit me 3.00.

*Tabela 2. Mbështetësit më të mëdhenjë të mësimit online gjatë pandemisë Covid19?*

<b>Si e vlerësoni mbështetjen e këtyre institucioneve gjatë periudhës së pandemisë Covid19?</b>					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
MASHTI	442	1	5	3.47	1.347
Komuna/DKA-të	442	1	5	3.20	1.376
Shkolla	442	1	5	3.93	1.274
Kolegët	442	1	5	4.19	1.025
Prindërit	442	1	5	3.00	1.449
Nxënësit	442	1	5	3.97	1.034


*Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimit online*

Mësimit online kanë deklaruar se kanë vërejtur interesim të madh te nxënësit e tyre për ndjekjen e mësimit online gjatë kohës së pandemisë. Në një shkallë nga 1 që nënkupton aspak interesim deri në 5 që nënkupton interesim shumë të lartë, ata kanë treguar se nxënësit kanë shprehur interes të lartë, ku mesatarja e të gjitha përgjigjeve është 3.98. Ndarja e përgjigjeve për secilin opsion është e paraqitur në grafikun në vijim.

Figura 10. Interesimi i nxënësve të shkollave të mesme për mësimin online

Si e vlerësoni interesimin e nxënësve tuaj për mesimin online? (5 =shume te interesuar - 1 =aspak te interesuar)

443 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit


Çka është më e rëndësishme, pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë treguar se interesi i nxënësve është shtuar edhe më shumë pasi ata kanë ndjekur trajnimin dhe kanë mundet t'i aplikojnë aftësitë e fituara nga trajnimi në klasët e tyre online. Nga 441 mësimdhënës të shkollave të mesme që kanë ndjekur trajnimin, 80.7% kanë treguar se interesimi i nxënësve është shtuar (prej tyre 38.1% kanë thënë se interesimi është shtuar dukshëm) pasi ata kanë filluar të aplikojnë njohuritë e fituara gjatë trajnimit. Ndërsa, 18.6% e mësimdhënësve kanë thënë se interesimi ka mbetur i njejtë dhe vetëm 3 mësimdhënës kanë deklaruar se interesimi ka rënë.

Aspektet e mësimdhënies online në të cilat mësimdhënësit konsiderohen se kanë përfituar më së shumti njohuri dhe në aplikimin e të cilave ndihen më komod janë Përdorimin e mjeteve dixhitale për organizimin e orëve online (Zoom, Hangouts dhe Meets) e zgjedhur nga 90.1% e mësimdhënësve, angazhimin e nxënësve e zgjedhur nga 63.9% e tyre, aktivitetet dhe metodologjinë pedagogjike e zgjedhur nga 46.3%, si dhe vlerësimin e nxënësve e zgjedhur nga 44.2%

Figura 11. Ndryshimi në interesin e nxënësve të shkollave të mesme për mësimin online

**A keni verejtur interesim te shtuar te nxenesve pas aplikimit te njohurive nga trajnimi**

441 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

Këto rezultate tregojnë se trajnimi i ofruar ka qenë shumë i efektshëm në zhvillimin e aftësive të mësimdhënësve për ta organizuar orën mësimore në një ënyrë që e bën të mësuarit kreativ dhe të frytshëm për nxënësit.

Megjithatë, mësimdhënësit deklarojnë se ende kanë nevojë për trajnime shtesë në shumicën e aspekteve të përmendura, me fokus më të madh në vlerësimin e nxënësve (54.4%), aktivitetet dhe metodologjinë pedagogjike (39.3%), përdorimin e mjeteve digjitale për organizmin e mësimin online (36.6%) dhe angazhimin e nxënësve (20%).

Figura 12. Përfitimet e mësimdhënësve nga trajnimi

Sa ju ka ndihmuar trajnimi në Kolegjin Universum?					
	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.
Perdorimit te metodologjise se mesimdhënies	442	1	5	4.14	.917
Vleresimit te nxenesve	442	1	5	4.18	.889
Perdorim te teknologjise ne pergjithesi	442	1	5	4.32	.920
Krijimi te nje kursi ne LMS (Google Classroom)	442	1	5	4.47	.860
Perdorimit te platformave per mesimdhënie online, si Zoom, Google Hangout, Google Meetj, etj.	442	1	5	4.55	.761

Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit


Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit kanë vlerësuar se trajnimi i ka ndihmuar ata në masë të madhe në të gjitha aspektet e organizimit të mësimit online. Siç shihet në tablën e mësipërme, të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të mësimit online kanë marrë vlerësim mesatar mbi 4 në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 nënkupton se trajnimi nuk u ka ndihmuar aspak dhe 5 nënkupton se trajnimi ju ka ndihmuar shumë. Më së larti është vlerësuar ndihma që trajnimi u ka ofruar mësimdhënësve në përdorimin e platformave për mësimdhënie online si Zoom, Google Hangouts, Google Meets etj., ku kjo është vlerësuar me 4.55, pasuar nga krijimi in një kursi në LMS ((Google Classroom) me 4.47.

Në përgjithësi, mësimdhënësit kanë shprehur nivel të lartë të kënaqësisë me trajnimin e ofruar nga ISEPS dhe Kolegji Universum. 95.5% e tyre e kanë vlerësuar trajnimin si të dobishëm, me 72% duke e vlerësuar si shumë të dobishëm. Ata gjithashtu kanë komentuar se trajnimi përveç aftësisë së tyre në aspektin teknik të përdorimit të mjeteve digjitale u ka ndihmuar shumë edhe në aspektin pedagogjik duke u fokusuar në aktivitetet dhe metodologjitë pedagogjike për rritjen e angazhimit dhe performancës së studentëve.

Figura 13. Vlerësimi i mësimdhënësve për trajnimin "Mjetet dixhitale dhe mësimdhënie online"

Ne pergjithesi si do te vleresonit trajnimin per Mjetet Dixhitale dhe Mesimdhënie Online? (5= shume i dobishem ndersa 1=aspak i dobishem)

443 responses



Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

### 3.2. Ndikimi i trajnimit në zhvillimin e njohurive për organizmin e mësimit online te mësimeve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta

Mësimeve të shkollave fillore të mesme të ulëta kanë marrë pjesë në numër të vogël në trajnim, por vlerësimi i tyre për trajnimin dhe përfitimet prej tij është i ngjashëm me atë të shkollave të mesme.


Nga 223 mësimeve, 92.8% kanë deklaruar se edhe po të kthehej sërish mësimeve të drejtpërdrejta ata do të aplikojnë disa aspektet e mësimit online në punën e tyre, ndërsa 6.3% janë shprehur të pasigurtë.

Elementet e mësimit online të cilat ata kanë deklaruar se do të vazhdojnë t'i përdorin janë ndarja e linqeve, videove dhe materialeve të tjera elektronike me studentët (i zgjedhur nga 85.5% i tyre, përdorimi i Google Classroom ose LMS të tjerë për organizmin e klasëve (82.8%), përdorimi i mjeteve digjitale si Zoom, Hangouts dhe Meets (67.9%), incizimi dhe shpërndarja e ndonjë pjese të ligjeratës (67.4%), si dhe përdorimi i vlerësimit edukues (52.5%).

Figura 14. Vazhdimi i përdorimit të elementeve të mësimit online në të ardhmen

**Nese mesimdhënia e drejtpërdrejte (F2F) do te kthehet ne shtator, a do te vazhdoni te aplikoni aspekte te mesimdhënies online?**

223 responses




Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimeve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta

Pjesa dërmuese e mësimit online, 95.1% më konkretisht, mendojnë se mësime online duhet të jetë pjesë e planprogrameve shkollare edhe në të ardhmen. Një përmbledhje e përgjigjeve të tyre është e paraqitur më poshtë.

Figura 15. Përfshirja e mësimit online në plan programet e ardhshme

A mendoni që mësime online duhet të jetë pjesë e planprogramit edhe në të ardhmen?

223 responses




Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësime online

Ngjashëm me mësuesit e shkollave të mesme, edhe ata të shkollave fillore kanë deklaruar se ndihmën më të madhe për krijimin e kurseve online gjatë kohës së pandemicë e kanë marrë nga kolegët e tyre (45.7%), pastaj nga shkolla ku ata punojnë (28.7%), MASHTI (17.9%) dhe komunat e DKA-të (8.1%). është shqetësues fakti që më shumë se një e treta (39.9%) e tyre kanë deklaruar se nuk kanë marrë ndihmë nga askush rreth krijimit të kurseve dhe klasëve online.

Figura 16. Ndhimja e pranuar në krijimin e klasëve online gjatë pandemisë Covid19

A keni marrë ndihme nga dikush tjetër për të krijuar kursin online?

223 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

Kurse në përgjithësi mbështetjen më të madhe gjatë pandemisë Covid19 mësimdhënësit deklarojnë se e kanë marrë nga nxënësit, kolegët dhe shkollat e tyre, përderisa kanë marrë shumë më pak mbështetje nga komunat dhe MASHTI. Më specifikisht, në një shkallë nga 1 që nënkupton aspak mbështetje deri në 5 që nënkupton mbështetje e madhe, mësimdhënësit e kanë vlerësuar mbështetjen e nxënësve të tyre në këtë proces me 4.16, pastaj atë të kolegëve me 4.07 dhe të shkollave me 4.02. Përderisa mbështetjen e MASHTI-it e kanë vlerësuar me 3.8 dhe atë të komunave me 3.4.

Tabela 3. Ndhimja e ofruar për mësimdhënësit gjatë kohës së pandemisë

Si e vlerësoni mbështetjen e këtyre institucioneve gjatë periudhës së pandemisë?					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Ministria	223	1	5	3.80	1.192
Komuna/DKA-të	223	1	5	3.40	1.318
Shkolla	223	1	5	4.02	1.213
Koleget	223	1	5	4.07	1.201
Prinderit	223	1	5	3.59	1.308
Nxenesit	223	1	5	4.16	1.064


Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

Mësimdhënësit gjithashtu kanë vlerësuar se nxënësit e tyre kanë pasur interesim relativisht të lartë për mësimin online. 46.2 e kanë vlerësuar interesimin e nxënësve të vetë me 4, 40.4% e kanë vlerësuar me shkallën 5 ndërsa 12.1% kanë vlerësuar se interesimi in xënësve të tyre është mesatar.

Figure 17. Interesimi i nxënësve të shkollave fillore për mësimin online

Si e vleresoni interesimin e nxenesve tuaj per mesimin online? (5 =shume te interesuar - 1 =aspak te interesuar)

223 responses




Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

Më tutje, 90% kanë vlerësuar se intersimi in xënësve për mësimin online është shtuar pasi këta kanë filluar aplikimin e njohurive që i kanë fituar gjatëtrajnitimit dhe 9.9% kanë deklaruar se interesimi ka mbetur i njejtë.

Figure 18. Ndryshimi i nxënësve të shkollave fillore për mësimin online

### A keni verejtur interesim të shtuar të nxenesve pas aplikimit të njohurive nga trajnimi

222 responses



Burimi: Pyetësi për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimdhënësit

Pas ndjekjes së trajnimit, 94.2% e mësimdhënësve të klasëve 1-9 kanë deklaruar se ata ndjehen shumë komod në përdorimin e mjeteve dixhitale për organizimin e orëve mësimore online (Zoom, Hangouts dhe Meet). 64.1% e tyre ndihen komod në angazhimin e nxënësve gjatë njësisë mësimore, 47.5% ndjehen komod në praktikimin e aktiviteteve dhe metodologjisë pedagogjike dhe 57% në vlerësimin e përfundimit të studentëve. Ndonëse në këtë të fundit ata deklarojnë se kanë ende më së shumti nevojë për trajnim shtesë.

Kur janë pyetur se sa u ka ndihmuar trajnimi i mbajtur nga ISEPS me organizimin dhe mbajtjen e mësimin online, në një shkallë nga 1 që nënkupton aspak dhe 5 që nënkupton shumë, mësimdhënësit e kanë vlerësuar me 4.7 ndihmën që trajnimi u ka ofruar në krijimin e kurseve në LMS (Google Classroom) dhe në përdorimin e platformave për mësimdhënie online, si Zoom, Google Hangout, Google Meets etj. Vlerësim të tillë të lartë kanë shprehur për të gjitha aspektet e organizimit të mësimin online, siç mund të shihet në tabelën në vijim.

Tabela 4. Ndikimi i trajnimit në zhvillimin e njohurive teknologjike te mësimeve në mesimdhënësit

<b>Sa te ka ndihmuar trajnimi ne Kolegjin Universum në aspektet e mëposhtme?</b>					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Dev.
Perdorim te teknologjise ne pergjithesi	223	2	5	4.62	.646
Krijimi te nje kursi ne LMS (Google Classroom)	223	2	5	4.70	.588
Perdorimit te metodologjise se mesimdhënies	223	2	5	4.42	.711
Vleresimit te nxenesve	223	2	5	4.45	.745
Perdorimit te platformave per mesimdhënie online, si Zoom, Google Hangout, Google Meetj, etj.	223	2	5	4.70	.579

Burimi: Pyetësori për vlerësimin e trajnimit i realizuar me mësimeve në mesimdhënësit

Në përgjithësi, mësimeve në mesimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta e kanë vlerësuar trajnimin e ofruar nga ISEPS dhe Kolegji Universum me 4.84 nga 5 (pikë) të mundshme. Ata kanë deklaruar se trajnimi ka pasur ndikim shumë pozitiv te vetë ata dhe te nxënësit e tyre dhe janë të interesuar të ndjekin trajnime të ngjashme edhe pas përfundimit të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë, si dhe shprehen të përkushtuar të aplikojnë elemente të mësimin online edhe në të ardhmen.

#### 4. Diskutim i rezultateve dhe përfundime

Nga rezultatet e fituara përmes pyetësorëve të realizuar para dhe pas mbajtjes së trajnimit “Mjetet dixhitale dhe mësimeve online” shihet se mësimeve në mesimdhënësit e nivelit fillor, të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë kanë pasur njohuri të kufizuara lidhur me dizajnimin e lëndës dhe përdorimin e mjeteve teknologjike për qëllime të mësimeve online. Gjithashtu shihet se trajnimi ka pasur ndikim shumë pozitiv në ngritjen e njohurive të tyre në krijimin e klasës në platformën Google Classroom, në përdorimin e platformave si Zoom, Google Meets, Google Hangouts, Moodle etj. për mbajtjen e sesioneve online të mësimin si dhe në përdorimin e metodologjive pedagogjike dhe të vlerësimit që maksimizojnë të mësuarit e nxënësve në një ambient online.

Një ndikim i rëndësishëm i trajnimit del të jetë ngritja e interesimit të mësimeve në mesimdhënësve për përdorimin e elementeve të mësimin online edhe në të ardhmen pas kthimit të mësimin të drejtpërdrejtë në klasët fizike dhe shtimi i interesimit të nxënësve për pjesëmarrje në sesionet e mësimin online.

Përkundër efektit pozitiv që ka pasur trajnimi te pjesëmarrësit, ata kanë shprehur nevojën edhe për trajnime të tjera të ngjashme në të ardhmen me qëllim të përfitimit të njohurive edhe më të thella për aspektet e përfshira në këtë trajnim. Ndaj, kjo paraqet nevojën për organizimin e trajnimeve të ngjashme nga ISEPS dhe Kolegji Universum në të ardhmen që kanë në fokus mësimdhënien online, metodologjine pedagogjike dhe metodologjinë e vlerësimit. Me mundësi edhe për zgjerimin e tyre me elemente dhe aspekte të cilat lindin sipas nevojës gjatë kohës.

## Anekset

### Mësimdhënësit e klasëve 1-9

<b>Nr.</b>	<b>Shkolla</b>	<b>Komuna</b>
1	SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës"	Deçan
2	SHFMU "DRITA" GRAMAQEL	
3	ShFMU " Faik Konica "	
4	"Lidhja e Prizrenit"	
5	"Rexhep Gjeli"	Drenas
6	ShFMU "RASIM KIÇINA"	
7	ShFMU "Mehmet Gradica"	
8	"Bajram Curri"	
9	"Xheladin Gashi-Plaku"	
10	ShFMU" Abedin Bujupi"	
11	"7 Marsi"	Ferizaj
12	"Naim Frashëri"	
13	ShFMU "Liman Rekaj"	
14	ShFMU" Besim Rexhepi"	
15	ShFMU "Gjon Serreçi"	
16	"Zenel Hajdini"	
17	"Elena Gjika"	
18	ShFMU "Ahmet Hoxha"	
19	"Jeronim de Rada"	
20	"4 Prilli"	
21	"Lismiri"	Fushë Kosovë
22	"Laura Scotti"	
23	"Mihal Grameno"	
24	SHMU "Yll Morina"	Gjakovë
25	SHFMU "Gjergj Fishta"	
26	Gjimnazi "Hajdar Dushi"	
27	"Fehmi Agani"	
28	SHFMU "Ukshin Miftari"	
29	ShFMU "Selman Riza"	

30	"Luigj Gurakuqi"	
31	"Fan Noli"	
32	SHFMU " Dy dëshmorët"	
33	ShFMU "Dëshmorët e Kombit"	
34	ShFMU "Agim Ramadani" Zhegër	Gjilan
35	"Faik Konica"	
36	"Deshmorët e Kombit"	
37	"Vehbi Ibrahimimi"	
38	"Tre dëshmorët e shkollës shqipe"	Istog
39	Shfmu "Avni Zhabota"	Klinë
40	ShFMU "Zgjimi"	
41	"Dëshmorët e Qëndresës"	
42	"Fehmi Agani"	Lipjan
43	ShFMU " Vëllezerit Frashëri "	
44	"Ismail Luma"	
45	International Maarif Schools of Kosova	
46	"Dy Dëshmorët"	
47	"Hasan Zyko Kamberi"	
48	ShFMU "Rexhep Akllapi"	
49	"Kadri Beba"	
50	"Tafil Kelmendi"	Malishevë
51	ShFMU "Aziz Sylejmani"	Mitrovicë
52	ShMU "Shaban Idrizi"	
53	ShFMU "Fazli Greiçevci"	
54	Sh.m.e "Hasan Prishtina"	
55	ShFMU "Harun Beka"	
56	ShFMU " Bislim Imeri"	
57	"Shemsi Ahmeti"	
58	"Ismail Qemali"	
59	"Trepça"	
60	"Hanumshahe dhe Tefik Zymberi"	Novoberdë
61	"Migjeni"	Obiliq
62	"Naim Frashëri"	
63	ShFMU "Dr.Ibrahim Rugova"	

64	"Enver Maloku"	Podujevë
65	"Shaban shala"	
66	ShME "Isa Boletini"	
67	"Zahir Pajaziti"	
68	"Hilmi Rakovica"	Prishtinë
69	"Zenit"	
70	ShFMU "Pavaresia"	
71	ShFMU " Shkendija"	
72	ShFMU "Mehmet Gjevori"	
73	ShFMU "Emin Duraku"	
74	ShFMU "Nazim Gafurri"	
75	ShMT "28NENTORI"	
76	"Yjet e matematikës RMB"	
77	Akademia "Ora"	
78	"Faik Konica"	
79	"Naim Frasheri"	
80	'DARDANIA'	
81	ShFMU "Zenel Hajdini"	
82	ShMAT "AbdylFrasheri"	
83	ShMU "Gjergj Fishta"	
84	ShMM "Dr.Ali Sokoli" Prishtinë	
85	ShFMU "Zenel Hajdini"	
86	ShFMU "Meto Bajraktari"	
87	ShFMU "ILIRIA"	
88	"Elena Gjika"	
89	Shmm "Rezonanca"	
90	ShFMU "Emin Duraku"	
91	International School of Prishtina	
92	ShFMU "Iliria"	
93	ShFMU "Motrat Qiriazii"	Prizren
94	ShFMU "Emin Duraku"	
95	ShFMU "Fadil Hisari"	
96	"Ibrahim Fehmiu"	
97	ShFMU "Xhevat Berisha"	

98	"Zenun Çoçaj"	
99	ShFMU "Heronjtë e Lumës"	
100	"4 Dëshmorët"	Rahovec
101	"Ismet Uka"	Skënderaj
102	"Idriz Barani"	
103	"Ilir Lushtaku"	
104	"Shaban Mazreku"	Therandë
105	ShFMU "28 Nëntori"	
106	"Edit Durham"	
107	ShMT "Skender Luarasi"	
108	ShFMU "Ramë Bllaca"	
109	SHFMU "Destan Bajraktari"	
110	ShFMU "7 Marsi"	
111	"Safet Rexhepi"	Viti
112	ShFMU "Halil Alidema"	
113	"Njazi Rexhepi"	
114	"Rexhep Musa"	Vushtrri
115	ShFMU "Liria"	
116	SHMU 2	
117	"Hajrullah Shala"	
118	ShFMU "28 Nëntori"	
119	Akademia "Ora"	
120	"Andon Zako Çajupi"	
121	"Enver Hadri"	
122	SHMU-1	
123	"7 Marsi"	
124	SHFMU "Rilindja"	
125	Gjimnazi "Eqrem Çabej"	
126	"Mustafë Venhari"	
127	"Latif Berisha"	
128	ShFMU "Mihaliq"	

<b>Nr.</b>	<b>Emri i shkollës</b>	<b>Komuna</b>
1	SH.M.T "TAFIL KASUMAJ"	Decan
2	Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"	
3	SH.M.P. "Fehmi Lladrovci"	Drenas
4	Sh.m.I. Ruzhdi Berisha	Dragash
5	SH.M.A.T "Zenel Hajdin	Ferizaj
6	SH.M.M"Elena Gjika"	
7	SH.M.E "Faik Konica'	
8	Gjimnazi shoqerore "Shaban Hashani"	
9	Qendra e kompetences	Fushë Kosova
10	SHMEJ "Hivzi Sulejmani"	
11	Gjimnazi "Hivzi.Sulejmani"	
12	Gjimnazi "Hajdar Dushi"	Gjakovë
13	Sh.M.M "Hysni Zajmi" Gjakove	
14	SH.M.E "Kadri Kusari"	
15	SH.M.T "Nexhmedin Nixha"	
16	QAKP"Gjon N.Kazazi"-Gjakove	
17	Shkolla e muzikes "PRENK JAKOVA"	
23	Gjimnazi "Asllan Berisha" - Rogove	
24	SHMM " Dr Asllan Elezi "	Gjilan
25	Medresje Alauddin	
26	SH.M.E"Marin Barleti"	
27	Gjimnazi "Haxhi Zeka"	Istog
28	SH.M.T "Mithat Frasherit"	
29	SHMP 'Feriz Guri dhe Vellezerit Caka	Kacanik
30	Gjimnazi Kuveni i junikut	Junik
31	SH.M.L.M. " SEJDI KRYEZIU "	Kamenicë
32	Sh.M.L.P"Andrea Dursaku"	
33	SHMP "Fehmi Agani"	Klinë
34	Shkolla "Mileniumi i Trete "	
35	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi"	
36	SH.M.M "Keka-Med"	
37	Gjimnazi "Ulpiana"	Lipjan
38	SH.M.P. "Adem Gllavica"	
39	International Marif Sschool in Kosovo	
40	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"	Malishevë

41	SH.M.M "Dr.Xheladin Deda"	Mitrovicë
42	SH.M.T " Arkitekt Sinani "	
43	Gjimnazi natyror "Frang Bardhi"	
44	SH.M.E "Hasan Prishtina"	Obiliq
45	SH.M.P "	
46	SH.M.E "ISA BOLETINI"	Podujevë
47	SH.M.T "Fan S.Noli"	
48	SH.M.T "28 Nëntori"	Prishtinë
49	SH.M.A.T"Abdyl Frashëri"	
50	SH.M elektroteknike "Gjin Gazulli "	
51	SH.M.E "Hoxhë Kadri Prishtina"	
52	Gjimnazi shoqerore " Ahmet Gashi"	
53	Gjimnazi shkencor " Sami Frasheri"	
54	Shkolla e Muzikës "Prenk Jakova"	
55	Shkolla Zenit	
56	Sh.M.M. Dr.Ali Sokoli	
57	Shkolla "Don Bosko"	
58	Medreseja "Alauddin "	
59	NGO	
60	American Advising Center	
61	Gjimnazi shkencor "Xhevdet Doda"	
62	SH.M.M "Rezonanca"	
63	Gjimnazi i Filiologjisë "Eqrem Çabej"	
64	Gjimnazi "Hasan Nahi"	
65	SH. M.H. T."7 Shtatori" Prishtine	
66	SHFMU "Zenel Hajdini"	
67	SH.M.E "Ymer Prizreni"	
68	Gjimnazi shoqeror"Medreseja Alauddin"	
69	Gjimnazi shoqeror "Remzi Ademaj"	
70	International Maarif Schools of Kosova	
71	SH.M.L.T "11 Marsi"	
72	Shkolla Muzikes " Lorenc Antoni"	
73	Gjimnazi shkencor "Gjon Buzuku"	
74	SH.M.L "Xhelal Hajda-Toni"	Rahovec
75	SH.M.L "Ukshin Hoti"	
76	SH.M.L.P . " Selajdin Mullaabazi	

77	SH.M.L "12 Maji"	
78	"Osman Gjini" Mollas	Cërrik-Shqiperi
79	Gjimnazi "Kongresi i Manastirit" në Firajë	Shterpcë
80	Gjimnazi "Naim Frashëri" Shtime	Shtime
81	Shkolla e Mesme Profesionale - Shtime	
82	Shkolla e Kompetences	Skënderaj
83	Gjimnazi natyror "Jeta e Re"	Therandë
84	SH.M.T "Skender Luarasi"	
85	SH.M.P. "Abdyl Rama"	
86	Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës"	Viti
87	SHMT"Lutfi Musiqi"	Vushtrri
88	SHMP"Bahri Haxha"	
89	ShML - Gjimnazi "Eqrem Çabej"	